



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 07.02.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.02.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EKO TEST SHPK" për aktivitetin: "Zgjerimi i rrjetit të senzoreve të cilësive së ajrit dhe avansimi i rrjetit ekzistues" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7599-221** nxjerr:

### V E N D I M

**Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "EKO TEST SHPK" e datës 05.02.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Zgjerimi i rrjetit të senzoreve të cilësive së ajrit dhe avansimi i rrjetit ekzistues" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7599-221**, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 04.02.2020*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 04.02.2020;**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "EKO TEST SHPK" me datë 05.02.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrjetit të senzoreve të cilësive së ajrit dhe avansimi i rrjetit ekzistues" dhe me numër të prokurimit: **616 -19-7599-221**. Autoriteti Kontraktues, me datë 07.02.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se tenderuesi i propozuar për kontratë nuk ka ofruar asnjë kontratë për mirëmbajtje dhe servisim të paisjeve për monitorimin e cilësive së ajrit është i pa bazuar për faktin se në FDT nuk ka asnjë kërkesë të tillë, por kërkesa është e ofrohen dëshmi për kryerjen e shërbimeve të ngjashme që d.t.th.jo shërbime të njëjta siqë paraqitet në pretendimin tuaj;  
-Poashtu lidhur me pretendimin tjetër se i propozuari për dhenje të kontratës nuk ka ofruar katalog të paisjeve për mirëmbajtje është i pa bazuar dhe nuk nderlidhet me asnjë nga kërkesat e FDT-se, por ajo që dihet për të gjithë tenderuesit është se realizimi i kontratës duhet

te behet ne harmoni me kerkesat e Aneksit 1,ku jane dhene specifikimet per senzoret e kerkuar;

-Pretendimi per çmim enorm te ulet dhe per mos percaktimin e sherbimit te tenderuesit te propozuar ju sqarojme se sikurse nga ju edhe nga tenderuesi tjetër është kërkuar sqarimi lidhur me këte pozicion dhe i njëjti ka deklaruar se në çmim ka përfshirë edhe furnizimin edhe instalimin;

-Edhe pretendimi vijues është i pa bazuar,pasi që tenderuesi i propozuar për kontratë ka plotësuar të njëjtin përshkrim të çmimit dhe në të është precizuar qartë se mirëmbajtja kërkohet për 36 muaj dhe për të tjerë pika dhe ato që ju i përmendni për një pikë apo gjashtë nuk kanë të bëjnë aspak me kërkesat tona e as me ofertën e dorëzuar nga tenderuesi i propozuar për kontratë.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

**Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

**Shtojcë:Pergjeja e tenderuesit dhe pershkrimi i çmimit.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



# FW: Sqarime shtese

Kaltrina Dalipi

Mon 11/11/2019 2:26 PM

To: Shyhrete Abazi <Shyhrete.Abazi@rks-gov.net>; Seniha Bajraktari <Seniha.Bajraktari@rks-gov.net>;

Cc: Zeke Bardhaj <Zeke.Bardhaj@rks-gov.net>; Jehona Mavraj <Jehona.Mavraj@rks-gov.net>;

📎 1 attachment

Deklarate-K.K.Prishtine.pdf;

Po ashtu edhe sqarimet e OE.

**Me respekt,**

**Kaltrina Dalipi**

Zyrtare e Lartë e Prokurimit

Kabineti i Kryetarit

Komuna e Prishtinës

**e-mail:** [kaltrina.dalipi@rks-gov.net](mailto:kaltrina.dalipi@rks-gov.net)

tel: +381 (0)38 230 900 lok: 1129

**From:** Betim Sadriu [mailto:interlab.shpk@gmail.com]

**Sent:** 5 November, 2019 16:05

**To:** Prokurimi Prishtine; Kaltrina Dalipi

**Subject:** Sqarime shtese

Pershendetje e nderuar,

Te bashkangjitur mund te gjeni deklaratën nga ana e Interlab shpk lidhur me kete aktivitet te prokurimit: "Zgjerimi i rrjetit te senzoreve te cilesise se ajrit dhe avansimi i rrjetit ekzistues-RITENDER", me Nr. te prokurimit: 616-19-7559-2-2-1.

Me respekt!

**Ing. Betim Sadriu**

+377 44 517 811

Dardania SU5 - Prishtinë 10000,  
Kosovë



InterLab shpk  
Adresa: Idriz Gjilani Nr 65,  
10000 Prishtinë  
Email: [interlab.shpk@gmail.com](mailto:interlab.shpk@gmail.com)  
Tel: +37744517811

NB:601678008

## DEKLARATË

Interlab shpk pjesëmarrëse në tenderin me titull : **"Zgjerimi i rrjetit të senzoreve të cilësisë së ajrit dhe avansimi i rrjetit ekzistues RITENDER"**,

me numër të prokurimit : **616-19-7559-2-2-1**

- Deklarojmë se **pëvec instalimit ne do të bëjmë edhe furnizimin e dy sensorëve për matjen e cilësisë së ajrit.**

Ing. Betim Sadriu




Pershkrimi i cmimit

Specifikacionet funksionale	Njësia	Sasia	Çmimi njesi me TVSH	Totali ma TVSH
<p>Instalimi i 2 (dy) sensorëve për matjen e cilësisë së ajrit dhe ndërlicdja e tyre me 6 sensorët aktual, që janë në faqen zyrtare te komunës së Prishtinës.</p> <p>Te bëhet matja e këtyre paramerave: PM2.5, PM10, TPC (furnizimi me energi: solare, bateri, komunikimi me Server: 3G), Temperatura, Presioni atmosferik, RH% (Lagështia e ajrit) dhe zhurma</p> <p><b>Particle count</b> Optical particle counter Particles/cm<sup>3</sup> 0.30 to 30 µm <b>PM2.5</b> Optical particle counter µg/m<sup>3</sup> 0 to 500 µg/m<sup>3</sup> <b>PM10</b> Optical particle counter µg/m<sup>3</sup> 0 to 1,000 µg/m<sup>3</sup></p>	<p>copë</p> <p>µm</p> <p>µg/m<sup>3</sup></p>	<p>2</p> <p>2</p>	<p>4,425.00</p> <p>5,075.00</p>	<p>8,850.00</p> <p>10,150.00</p>
<p>Mirëmbajtja mujore për 8 (tetë) pikat me kohëzgjatje prej 36 muajve duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>fshirja,</li> <li>update te nevojshem ne web faqe,</li> <li>nderrimi i pajisjeve konsumuese si: bateria, sensorët e ndryshem, servisim dhe pastrim i panelit solar si dhe pastrimi i sensorëve.</li> </ul>	copë	8	837.70/ mujore	30,457.50



	* TOTALI me TVSH: <b>49,457.50€</b>
--	-------------------------------------

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
<b>Emri i Kompanisë</b>	EKO TEST SH.P.K
<b>Adresa e plotë:</b>	Dardani Bill Clinton 333,10000 Prishtinë,RKS
<b>I përfaqësuar nga:</b>	
<b>Emri</b>	Adnan Pajaziti
<b>Pozita</b>	Drejtor
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Data</b>	21.10.2019
<b>Vula</b>	